



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 390, datë 22.09.2021**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN  
NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT DURRËS, PËR POZICIONIN E LIRË  
NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 129,  
DATË 01.04.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, bazuar në rezultatet e shortit për zgjedhjen e relatorit,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e z. Ilir Toska si relator të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**